



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 550/4 Prot

Tiranë, më 26.11.2020

V E N D I M

Nr.163, datë 26.11.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me shkresën nr. 550 prot., datë 18.06.2020, të kërkuesit ***
në lidhje me një procedurë konkurrimi, të zhvilluar në Bashkinë Kamëz.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nëpërmjet një kërkese, paraqitur prej kandidatit *****
në lidhje me disa pretendime të tij, për paligjshmëri të kryera në procedurën e konkurrimit për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore”, në Bashkinë Kamëz,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 550 prot., datë 18.06.2020, kërkuesi ***** ka parashtruar disa pretendime për shkelje të procedurës administrative dhe të ligjit material nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në zhvillimin e procedurës së konkurrimit, nëpërmjet ngritjes në detyrë(edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil), për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore”, në Bashkinë Kamëz.

Nga verifikimi administrativ i kryer në këtë rast, rezulton e vërtetuar se njësia përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, ka publikuar shpalljen për zhvillimin e procedurës së konkurrimit,

nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për pozicionin e nivelit të mesëm drejtues “*Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore*”. Në aktin e shpalljes konstatohet që procedura e ngritjes në detyrë, ka qenë e hapur dhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushte dhe kërkesat për pozicionin e punës, duke caktuar si afat për dorëzimin e dokumentacionit nga konkurrentët, datën 15.06.2020.

Mbi këtë bazë, kandidati ***** ka dërguar dokumentacionin e kërkuar për pjesëmarrje në këtë konkurrim, në datën 12.06.2020, nëpërmjet Postës Shqiptare. Ky dokumentacion rezulton të jetë dorëzuar prej Postës Shqiptare dhe protokolluar pranë Bashkisë Kamëz, me nr. 4399 prot., datë 16.06.2020(*pra, një ditë tej afatit të përcaktuar*).

Ndërkaq, në ditën e përcaktuar për dorëzimin e dokumentacionit për pjesëmarrje në këtë procedurë konkurrimi, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, pasi ka verifikuar gjendjen e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët e interesuar, ka publikuar aktin “*Njoftim për vazhdimin e procedurave të pranimit*” ku konstatohet se, kandidati ***** nuk është përfshirë për pjesëmarrje në këtë procedurë konkurrimi. Nga përmbajtja e aktit të mësipërm, vërehet se është përzgjedhur vetëm një kandidat i vlefshëm për këtë procedurë dhe mbi këtë bazë është caktuar zhvillimi i testimit me shkrim, në datën 17.06.2020.

Ndodhur në këto kushte, me pretendimin se ai e ka dorëzuar në afat dokumentacionin nëpërmjet postës, kandidati ka paraqitur një ankesë, të protokolluar me nr. 4575 prot., datë 19.06.2020, pranë Bashkisë Kamëz, duke kërkuar që t’i merrej parasysh aplikimi i tij. Në përgjigje të ankesës, Bashkia Kamëz me shkresën nr. 4575/1 prot., datë 23.06.2020, ka informuar kandidatin në fjalë se dokumentacioni i sjellë prej Postës Shqiptare është paraqitur në këtë institucion tej afatit ligjor (*në datën 16.06.2020*) dhe për këtë arsye, Komiteti i Përhershëm i Pranimit nuk e ka shqyrtuar këtë dokumentacion.

Ndërkaq, ditën e caktuar për zhvillimin e testimit me shkrim (17.06.2020) për shkak të mosparaqitjes së asnjë konkurrenti, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, me aktin nr. 45/4, datë 19.06.2020, ka njoftuar përfundimin e procedurës së konkurimit pa kandidatë fitues, akt i cili rezulton të jetë publikuar nga njësia përgjegjëse në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.

Duke analizuar gjithë sa më sipër, bazuar si në pretendimet e ankuesit ashtu dhe tek dokumentacioni i dërguar nga institucioni, arrihet në përfundimin se në procedurën e konkurimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore*”, janë lejuar/kryer shkelje nga ana e njësisë përgjegjëse, të cilat renditen më poshtë:

Së pari, në nenin 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohet se: “...organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira”.

Në respektim të parimit të shanseve të barabarta, nënkuptohet se procedura e ngritjes në detyrë duhet të zhvillohet në të njëjtën kohë, si për nëpunësit civilë që kërkojnë ngritje në detyrë ashtu edhe për kandidatët e tjerë, nga jashtë shërbimit civil. Në vijim të këtij arsyetimi, edhe dorëzimi i dokumentacionit për këtë procedurë konkurrimi, për të dy kategoritë e kandidatëve duhet të ishte caktuar të bëhej në të njëjtën ditë.

Në rastin konkret, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se njësia përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, ka vendosur dy afate të ndryshme për dorëzimin e dokumentacionit (konkretisht datë 10.06.2020 për nëpunësit civilë dhe 15.06.2020 për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil), fakt i cili vjen në kundërshtim me parimet thelbësore, mbi të cilat zhvillohen procedurat e konkurrimit.

Së dyti, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Kamëz nuk ka respektuar afatet e verifikimit paraprak të kandidatëve, si dhe të drejtën e tyre të ankimit, të cilat përcaktohen në pikën 22 - 26, të Kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Akti i mësipërm nënligjor përcakton se, njësia përgjegjëse duhet të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, duke njoftuar individualisht kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Më tej, po në këtë akt nënligjor, përcaktohet se, kandidatët të cilët për shkaqe të ndryshme, nuk janë kualifikuar për të vijuar më tej procesin e konkurrimit, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë njësisë përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të tyre.

Në rastin konkret, konstatohet se afatet e mësipërme nuk janë respektuar nga njësia përgjegjëse, pasi rezulton se ajo ka vendosur zhvillimin e testimit me shkrim vetëm 2 ditë pas kalimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, duke i mohuar në këtë mënyrë kandidatit ***** të drejtën e ankimit.

Së treti, konstatohet se, për vlerësimin e kandidatëve të kualifikuar për procedurën e ngritjes në detyrë, për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit, ndërkohë që në vendimin 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, përcaktohet se shqyrtimi, verifikimi dhe vlerësimi i kandidatëve për këtë procedurë konkurrimi duhet të zhvillohet nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se parregullsitë e evidentuara më sipër, kanë ardhur si pasojë e mosnjohjes dhe interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore, që rregullojnë procedurën për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët e të mesëm drejtues, nëpërmjet ngritjes në detyrë edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Megjithatë, pavarësisht shkeljeve të kryera apo lejuara nga njësia përgjegjëse e bashkisë, të renditura më sipër, duhet thënë se Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në kushtet kur ka marrë vendimin për shpalljen e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, duke mos përfshirë në këtë listë konkurrentin ******, ka vepruar në përputhje me ligjin dhe kushtet konkrete, pasi në momentin e marrjes së vendimit, dokumentacioni i aplikimit të këtij konkurenti, nuk ishte dorëzuar nga Posta Shqiptare (*vërtetohet se ky dokumentacion është dorëzuar një ditë më vonë*). Po kështu, vlerësohet i marrë në përputhje me ligjin dhe kushtet konkrete, edhe vendimi i këtij organizmi, për përmbylljen pa fitues të procedurës së konkurrimit, kur ditën e caktuar në dt. 17.06.2020, nuk u paraqit asnjë konkurrent.

Në këto rrethana, kur efektivisht nuk vërehet ndonjë veprim i qëllimshëm, për vënien në pozita diskriminuese të konkurentit në fjalë, nga ana e njësisë përgjegjëse dhe Komitetit të Përhershëm të Pranimit, të Bashkisë Kamëz, por kjo lidhet me një mosveprim në kohën e duhur, të një organizmi tjetër, të pavarur nga bashkia (Postës Shqiptare) e për më tepër, kur kjo procedurë nuk është finalizuar me një akt emërimi por ka përfunduar pa fitues, gjë që i hap rrugën mundësisë së rishpalljes së konkurrimit për plotësimin e pozicionit, proces ku mundësohet edhe pjesëmarrja e kandidatit ******, arrihet në përfundimin se ky hetim administrativ duhet të përfundojë pasi aktualisht nuk ka një objekt konkret dhe çështja të arkivohet, duke pasur parasysh që shkeljet e evidentuara më lart, në kryerjen e kësaj procedure konkurrimi, të mos përsëriten në të ardhmen.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 16, pika 6, të Kreut III “Procedura paraprake”, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 550 prot., datë 18.06.2020, të ankuesit *****, në lidhje me pretendimet për parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore*”, në Bashkinë Kamëz, pasi aktualisht nuk ka një objekt konkret dhe arkivimin e çështjes.
2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, të marrë masa për plotësimin nëpërmjet procedurës së konkurrimit të pozicionit të punës “*Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore*”, duke marrë në konsideratë orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, si dhe përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.
3. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Kamëz dhe kërkuesi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha